



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South



RAPORTI I PUNËS SË KOMITETIT PËR KOMUNITETE TË KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT PËR PERIUDHËN JANAR – DHJETOR 2024

Mitrovicë e Jugut , Dhjetor 2024

PËRMBAJTJA

1. Rreth Komitetit për Komunitete

1.1 Plani i punës

2. Aktivitetet e realizuara

3. Bashkëpunimet me akterë vendor dhe ndërkombëtar

4. Të arriturat dhe sfidat

5. Konkluzionet dhe Rekomandimet

1. RRETH KOMITETIT:

Komiteti për komunitete përfshinë në radhët e veta shumicën e thjeshtë nga anëtarët e kuvendit të komunës, anëtarët tjerë janë përfaqësuesit e komuniteteve. Çdo komunitet që jeton në komunë përfaqësohet nga, së paku një përfaqësues në komitetin për komunitete. Përfaqësuesit e komuniteteve joshumicë në komunë e përbëjnë shumicën e anëtarëve të komitetit të komuniteteve.

Komiteti i komuniteteve është përgjegjës për shqyrtimin e përputhshmërisë së autoriteteve komunale me ligjin në zbatim dhe për shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për t'u siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht. Komiteti gjithashtu i rekomandon kuvendit të komunës masat që duhet të ndërmerren për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komuniteteve për t'u avancuar, shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor, si dhe për të siguruar mbrojtje adekuate të të drejtave të komuniteteve brenda komunës.

DETYRAT KRYESORE THEMELORE TË KOMITETIT PËR KOMUNITETE

SHQYRTIMI I LEGJISLACIONIT KOMUNAL

- Shqyrtimi i të gjitha praktikave, politikave dhe aktiviteteve komunale Paraqitja e legjislacionit dhe mbledhjes e KK ofron udhëzime për organet komunale mbi kornizën ligjore dhe institucionale për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve.
- Shqyrton dhe përcjellë respektimin e formave, procedurave dhe kushteve për përfshirjen dhe pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve në proces vendimmarrjeje dhe planifikimi, si dhe siguron që rekomandimet e KK-së zbatohen.
- Raporton të paktën dy herë në vit në kuvendin e komunës dhe tek kryetari i komunës për veprimet, aktivitetet dhe rekomandimet e KK-së.
- Monitoron zbatimin e rekomandimeve të nxjerra.

SHQYRTIMI I TË GJITHA PRAKTIKAVE, POLITIKAVE DHE AKTIVITETEVE KOMUNALE

- Rishikon projektbuxhetin vjetor të komunës dhe avokon për përfshirjen e mjeteve dhe fondeve për aktivitetet që synojnë promovimin e të drejtave të komuniteteve.
- Rritë kapacitetet e autoriteteve komunale për të arritur tek komunitetet dhe për t'iu përgjigjur nevojave të tyre.
- Siguron që komuniteteve t'u mundësohet t'i shprehin nevojat e tyre dhe që të njëjtat të përfshihen në planet e reagimit/veprimit nëse ka interes që kjo të bëhet për komunitetet.
- Monitoron dhe i raporton në baza të rregullta kuvendit të komunës për zbatimin e projekteve për komunitetet dhe këshillon/konsulton ZKKK-në dhe, nëse është e nevojshme, kryetarin e komunës për zbatimin e projekteve të tilla nëse kërkohet.
- Konsultohet me ZKKK-në për përzgjedhjen e projekteve me prioritet për komunitetet.

PARAQITJA E LEGJISLACIONIT DHE MBLEDHJES E KK

- Formulon dhe diskutojnë rekomandimet me kryetarin, kuvendin komunal dhe komitetet e tij si dhe drejtoritë komunale.
- Çdo akt, plan, strategji dhe buxhet vjetor komunal i propozuar i paraqitet komitetit në fazën fillestare.
- Rekomandimet e bëra nga komiteti të përfshihen në materialin që u dorëzohet anëtarëve të kuvendit të komunës.
- Nëse rekomandimet e komitetit nuk përfshihen në rregulloren e propozuar komunale nga kuvendi i komunës brenda dy javësh, KK kërkon arsyetim me shkrim nga kuvendi.
- Komiteti duhet të mbledhet të paktën një herë në muaj.
- Kreu ose i deleguari i ZKKK-së informon komitetin për raportin e tij të punës tremujore, të kryer nga ajo zyrë.

PËRBËRJA E KOMITETIT PËR KOMUNITETE ËSHTË:

1. Jeton Rrahmani, përfaqësues i Komunitetit Egjiptian (Kryesues)
2. Elidiana Budini Haziri, përfaqësuese e VV -së (zv.Kryesuese)
3. Gazmend Asllani, përfaqësues i LDK-së
4. Xhafer Preteni, përfaqësues i PDK-së
5. Majlinda Kurti , përfaqësuese e PDK-së
6. Ardita Latifi Aliu, përfaqësuese e AAK-së
7. Xhevrije Bahtiri, përfaqësuese e VV-së
8. Anesa Colakovic , përfaqësuese e Komunitetit Boshnjak
9. Esat Krasniqi, përfaqësues i Komunitetit Ashkali
10. Agron Jashari përfaqësues i Komunitetit Turk
11. Habib Hajdini, përfaqësues i Komunitetit Rom

1.1 PLANI I PUNËS PËR VITIN 2024

Objektiva 1:

| Objektivat operacionale | Aktivitetet | Treguesit e verifikueshëm | Supozimet | Afati kohor |
|--|--|--|---|---------------|
| Mbikëqyrja në mënyrë të drejtpërdrejtë në realizmin e plotë të të drejtave, lirive dhe interesave të bashkësive etnike të cilat jetojnë në territorin e Komunës së Mitrovicës. | <ul style="list-style-type: none"> ▪ Përfaqësuesit të komuniteteve jo shumicë, antëtarit e KK-ve të raportojnë rregullisht për gjendjen aktuale të komunitetit që e përfaqësojnë gjatë mbledhjeve të rregullta ▪ Të ftohen sipas nevojës përfaqësues të tjerë të komuniteteve jo shumicë për plotësim informatave lidhur me përditshmërinë ▪ Të bashkëpunohet ngushtë me KKSK dhe KLSP. | <ul style="list-style-type: none"> ▪ Procesverbalet e mbledhjeve ▪ Ftesat që i dërgohen përfaqësuesve të komuniteteve jo shumicë | <ul style="list-style-type: none"> ▪ Krijimi i kushteve të përshtatshme për realizimin e mbledhjeve të rregullta | Sipas nevojës |

Objektiva 2:

| Objektivat operacionale | Aktivitetet | Treguesit e verifikueshëm | Supozimet | Afati kohor |
|-------------------------|-------------|---------------------------|-----------|-------------|
| | | | | |

| | | | | |
|---|---|--|---|---------------------|
| Angazhim në ruajtjen dhe mbrojtjen e identiteteve dhe vlerave etnike , kulturore, fetare , mendimit politik dhe çfarëdo mendimi tjetër pavarësisht nga përkatësia etnike. | <ul style="list-style-type: none"> ▪ Komunikimi dhe realizimi i bashkëpunimit me përfaqësuesit e komuniteteve jo-shumicë si dhe OJQ-ve nga këto komunitete | <ul style="list-style-type: none"> ▪ Procesverbalet e mbledhjeve ▪ Ftesat që i dërgohen përfaqësuesve të komuniteteve jo shumicë si dhe OJQ-ve | <ul style="list-style-type: none"> ▪ Krijimi i kushteve të përshtatshme për realizimin e mbledhjeve të rregullta | Janar- Dhjetor 2022 |
|---|---|--|---|---------------------|

Objektiva 3:

| Objektivat operacionale | Aktivitetet | Treguesit e verifikueshëm | Supozimet | Afati kohor |
|---|---|---|--|--|
| Shqyrtimi i të gjitha kërkesave dhe ankesave të cilat i drejtohen këtij Komiteti. | <ul style="list-style-type: none"> ▪ Kërkesat dhe ankesat pranohen dhe shqyrtohen në mbledhjet e rregullta të KK | <ul style="list-style-type: none"> ▪ Procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura ▪ Konkluzionet të drejtohen te organet kompetente Komunale | <ul style="list-style-type: none"> ▪ Konkluzionet të shqyrtohen nga ana e organeve kompetente të cilat janë adresuar. | Gjatë mbledhjeve të rregullta ose jashtëzakonshme të KK-së |

Objektiva 4:

| Objektivat operacionale | Aktivitetet | Treguesit e verifikueshëm | Supozimet | Afati kohor |
|---|--|---|---|--|
| Shqyrtimi i raporteve vjetore të Zyrës komunale për komunitete dhe kthim. | <ul style="list-style-type: none"> ▪ Zyrtari i ZKKK-së raporton rregullisht gjatë mbledhjeve të KK_së | <ul style="list-style-type: none"> ▪ Procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura | <ul style="list-style-type: none"> ▪ Rekomandi me ZKKK-së për kompletimin e raporteve me të dhëna statistikore | Raporti periodik 3 muhor, 6 muhor dhe final i vitit ne muajin Dhjetor. |

Objektiva 5:

| Objektivat operacionale | Aktivitetet | Treguesit e verifikueshëm | Supozimet | Afati kohor |
|---|--|---|--|---|
| Vizitë komuniteteve më qëllim informimi për gjendjen në të cilën jetojnë, dhe krahasimin e gjendjes se vitit 2021 | <ul style="list-style-type: none"> ▪ Komuniteti Shqiptarë ▪ Komuniteti Ashkali ▪ Komuniteti Rom ▪ Komuniteti Turk ▪ Komuniteti Boshnjak ▪ Komuniteti Egjiptian | <ul style="list-style-type: none"> ▪ Informatat në mbledhje të rregullta për vizitat e realizuara ▪ Dëshimtë ë mundshme (fotografiteë, inqizimet etj) | <ul style="list-style-type: none"> ▪ Të vizitohen të gjitha komunitetet pa dallim etnik nga antarë të KK-së | Janar- Shkurt Mars-Prill Maj-Qershor Korrik-Gusht Shtator-Tetor Nentor-Dhjetor |

Objektiva 6:

| Objektivat operacionale | Aktivitetet | Treguesit e verifikueshëm | Supozimet | Afati kohor |
|---|--|--|--|--------------------|
| Identifikimi i nxënësve të komuniteteve pakicë të cilët e kanë ndërprerë shkollimin dhe ndërmarrja e veprimeve për përfshirjen e tyre në procesin mësimor | <ul style="list-style-type: none"> ▪ Të vizitohen shkollat në pjesën jugore ▪ Raportimi i përfaqësuesve të komuniteteve lidhur me gjendjen reale për realizimin e procesit mësimor ▪ Të bisedohet me DKA ▪ Të gjendet mundësia e bashkëpunimit më KK-në e pjesës veriore | <ul style="list-style-type: none"> ▪ Raportet nga takimet ▪ Procesverbalet nga mbledhjet e KK-së | <ul style="list-style-type: none"> ▪ Shkëmbim e përvojave | Qershor Dhjetor |

Objektiva 7:

| Objektivat operacionale | Aktivitetet | Treguesit e verifikueshëm | Supozimet | Afati kohor |
|---|---|--|--|--------------------------------------|
| Planifikimi i punës së Komitetit për Komuniteteve 3muhor 6muhor Planifikim | <ul style="list-style-type: none"> ▪ Planifikimi me i detajuar i aktiviteteve të punës ▪ Specifikimi i aktiviteteve | <ul style="list-style-type: none"> ▪ Raportet nga takimet ▪ Procesverbalet nga mbledhjet e KK-së | <ul style="list-style-type: none"> ▪ Shkëmbim e përvojave | Janar Prill Qershor Shtator |

Objektiva 8:

| Objektivat operacionale | Aktivitetet | Treguesit e verifikueshëm | Supozimet | Afati kohor |
|---|---|--|--|---------------|
| Monitorimi strategjise per avancimin e te drejtave te komunitete Monitorim | <ul style="list-style-type: none"> ▪ Thirrja para pergjegjesise se institucioneve lokale me implementimin e strategjise ▪ Bashkepunimi me kabinetin e Kryetarit,ZKKK,Kuvend in dhe Drejtorite perkatese si dhe me OJQ te shoqerise civile. ▪ Angazhimi per nxerrjen e Planit te Veprimit per te drejtat e komuniteteve | <ul style="list-style-type: none"> ▪ Raportet nga takimet ▪ Procesverbalet nga mbledhjet e KK-së ▪ Strategjia per avancimin e te drejtave te komuniteteve Rom dhe Ashkali | <ul style="list-style-type: none"> ▪ Realizimi i masave afirmative per pjestaret e ketyre komunitete ve | Sipas nevojës |

Objektiva 9:

| Objektivat operacionale | Aktivitetet | Treguesit e verifikueshëm | Supozimet | Afati kohor |
|--|--|---|---|---------------|
| Monitorimi i zbatuesmerisë së gjuhës Turke në komunë e cila është gjuhë zyrtare në pordorimP | <ul style="list-style-type: none"> ▪ Takim me drejtorin e Administratës së përgjithshme ▪ Takim me përfaqësues të komunitetit Turk për të parë zbatimin në | <ul style="list-style-type: none"> ▪ Vendimi i Kuvendit Komunal për bërjen e gjuhës turke,gjuhë zyrtare në përdorim ▪ Nxerrja e dokumenteve | <ul style="list-style-type: none"> ▪ Zhvillimi dhe avancimi i përdorimit zyrtarë të gjuhës turke në bazë të Ligjit Nr. 02/L-37 PËR | Sipas nevojës |

| | | | | |
|--|----------|---|----------------------|--|
| | praktikë | komunale apo të gjendjës civile në gjuhën turke | PËRDORIMIN E GJUHËVE | |
|--|----------|---|----------------------|--|

Objektiva 10:

| Objektivat operacionale | Aktivitetet | Treguesit e verifikueshëm | Supozimet | Afati kohor |
|--|--|--|--|------------------------|
| Informata për regjistrimin e nxënësve të komuniteteve në shkolla Qershor-Shtator Planifikim | <ul style="list-style-type: none"> ▪ Ftesa në mbledhjet e Komitetit për përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë ▪ Takim me DKA ▪ Takim me Qendrën Mësimore “RADC” | <ul style="list-style-type: none"> ▪ Nr i nxënësve të komuniteteve të regjistruar | <ul style="list-style-type: none"> ▪ Nevoja për mësim plotësues ▪ Subvencionimi me bursa për nxënësit e shkollave të mësme ▪ Përkrahja me mjete shkollore | Qershor Shtator |

Objektiva 11:

| Objektivat operacionale | Aktivitetet | Treguesit e verifikueshëm | Supozimet | Afati kohor |
|--|--|---|--|--------------------------|
| Ndërmarrja e veprimeve për përfshirjen në procesin mesimor jo formal Planifikim | <ul style="list-style-type: none"> ▪ Bashkëpunimi me DKA ▪ Bashkëpunimi me organizata të shoqërisë civile ▪ Sesione me pjestarët e komuniteteve | <ul style="list-style-type: none"> ▪ Zhvillimi i mësimit për të rritur (shkolla e natës) | <ul style="list-style-type: none"> ▪ Zhdukja e analfabetizmit tek pjestarët e komuniteteve jo shumicë | Qershor Sipas Nevojës |

Objektiva 12:

| Objektivat operacionale | Aktivitetet | Treguesit e verifikueshëm | Supozimet | Afati kohor |
|---|---|--|---|---------------|
| Shqyrtimi i realizimit të rekomandimeve të Komitetit drejtuar strukturave relevante Planifikim | <ul style="list-style-type: none"> ▪ Zhvillimi i trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve të KpK (shqyrtimi i legjisllacionit) ▪ Antarët e KpK, (këshilltarët komunal) ngrisin çështjet e KpK në Kuvend ▪ Takim me Kryetarin e Komunës ▪ Takim me Kryesuesen e Kuvendit | <ul style="list-style-type: none"> ▪ Rekomandimet dhe Konkluzionet e dalura nga mbledhjet e Komitetit për Komunitete, zbatohen nga Ekzekutivi dhe Kuvendi | <ul style="list-style-type: none"> ▪ Me rekomandimet dhe konkluzionet e KpK njoftohen Kryetari i Komunës dhe Kryesuesja e Kuvendit | Sipas Nevojës |

Objektiva 13:

| Objektivat operacionale | Aktivitetet | Treguesit e verifikueshëm | Supozimet | Afati kohor |
|-------------------------|-------------|---------------------------|-----------|-------------|
| | | | | |

| | | | | |
|--|--|---|---|----------------------|
| Shkëmbimi i përvojave me KpK në komunat e Republikës së Kosovës. Planifikim | <ul style="list-style-type: none"> ▪ Takime të përbashkëta me një apo disa KpK nga Komunat e ndryshme të Kosovës ▪ Prezantimi i të arrituarave ▪ Krijimi i ideve të përbashkëta | Bashkëpunimi dhe Zhvillimi i ideve të përbashkëta | <ul style="list-style-type: none"> ▪ Shkëmbimi e përvojave | Dhjetor Janar |
|--|--|---|---|----------------------|

Objektiva 14:

| Objektivat operacionale | Aktivitetet | Treguesit e verifikueshëm | Supozimet | Afati kohor |
|--|--|---|--|--|
| Largimi i deponive ilegale të mbeturinave me theks të vecantë në lagjen “Adem Voca | <ul style="list-style-type: none"> ▪ Rekomandimi për pastrimin e deponisë ilegale ▪ Zhvillimi i fushatave apo kampanjave vetëdijësuese në komunitet dhe bashkëpunimi me drejtorinë e Ambientit | Krijimi i ambientit të pastër në lagjen “Adem Voca” | <ul style="list-style-type: none"> ▪ Mbjellja e fidaneve në vendin e deponisë | Janar Prill Qershor Shtator |

Objektiva 15

| Objektivat operacionale | Aktivitetet | Treguesit e verifikueshëm | Supozimet | Afati kohor |
|---|--|--|---|-------------|
| Takim i përbashket social me përfaqësuesit dhe akteret e tjerë relevant | <ul style="list-style-type: none"> ▪ Planifikimi i aktiviteteve të punës për vitin e ardhshëm ▪ Darkë e përbashkët fund viti | Vendosja e hapave konkret të bashkëpunimit | <ul style="list-style-type: none"> ▪ Shkëmbimi e përvojave | Dhjetor |

2. AKTIVITETET E REALIZUARA

Përgjatë kesaj periudhe, Komiteti për Komunitete ka realizuar këto aktivitete:

Në mbledhjen e 24-të mbajtur me datë 31.01.2024, është shqzrtuar Raporti i punës së ZKKK-së për periudhën Janar- Dhjetor 2023

Pasi që i është dhënë fjala nga kryesuesi i Komitetit për komunitete z. Jeton Rrahmani, shefja e zyrës znj. Snezana Nestorovic, bëri prezantimin e raportit për vitin 2023. Anëtarët e Komitetit për Komunitete filluan diskutimin dhe pyetje tyre. Në fund në mënyrë unanime Komiteti për Komunitete aprovoi raportin e ZKKK-së për periudhën Janar-Dhjetor 2023.

Në mbledhjen e 25-të mbajtur me 25.02.2024:

Anëtarët e Komitetit për Komunitete, diskutuan lidhur me ruajtjen dhe mbrojtjen e identiteve dhe vlerave etnike, kulturore, fetare, mendimit politik dhe çfarëdo mendimi tjetër pavarësisht nga përkatësia etnike, ku gjatë këtij diskutimi u ngritën dy çështje. Mungesa e një zyrtari/e nga komunitetet Rom,Ashkali dhe Egjiptian në Zyren për Komunitete dhe Kthim, si dhe mungesa e ndriqimit publik në lagjet 2 Korriku dhe Adem Voca. Pas diskutimeve në mes të pranishmëve, komiteti për komunitete nxorri rekomandimin Komiteti për Komunitete i Rekomandon Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Infrastrukturës që të rregullohet ndriçimi publik në lagjen “Adem Voca” dhe në lagjen “2 Korriku”. Ky rekomandim u aprovua unanimitisht.

Në mbledhjen e 26-të mbajtur me 26.03.2024:

Në këtë mbledhje Planifikimi i Planit të punës u shtye për një mbledhje tjetër, ndërkohë që Komiteti për Komunitete vendosi që lidhur me realizimin e rekomandimeve të Komitetit drejtuar strukturave relevante, aranzhimin e takimeve me Kryetarin dhe Kryesuesen e Kuvendit, të gjithë anëtarët e KpK të shkojnë bashkarishtë në takim me Kryetarin e Komunës z. Bedri Hamza, kurdo që zyrtari i protokollit na e mundëson takimin në bazë të agjendës së Kryetarit

Në mbledhjen e 27-të mbajtur me 30.04.2024:

Gjatë diskutimit në mes të anëtarëve për tu informuar për gjendjen në të cilën jetojnë komunitetet joshumicë, u vendos të realizohen vizita në teren, Për planifikim më të mirë nga kryesuesi i komitetit z.Jeton Rrahmani është përgatitur një agjend rreth vizitave e cila ka qenë e përshtatëshme për anëtarët.

Vizita në teren me datën 08.05.2024:

Kryesuesi i Komitetit për Komunitete z.Jeton Rrahmani dhe anëtarët znj. Majlinda Kurti dhe z.Xhafer Preteni, z. Gazmend Asllani, si dhe anëtarë tjerë të këtij komiteti dhe përfaqësues të komuniteteve tjera j shumicë, vizituan Lagjën Adem Voca në Mitrovicë. Në këtë vizitë u pritëm në takim nga menagjeri i qendrës mësimorë RADC z. Edin Lahi dhe stafi i tij, me crast u njoftuam rreth aktiviteteve që kjo qendër mësimore ofron. Duke qenë evidente se shumica e fëmijëve nga kjo lagje vijojnë mësimin në sistemin paralel në Veri, kjo qendër përmes mësimi joformal i mundëson këtyre fëmijëve që të mësojnë nga kurrikula e MASHT, nga e cila është edhe e certifikuar. Vizitën e vazhduam në teren për të parë nga afër sfidat me deponinë ilegale, mungesa e ndriqimit publik etj.



Në mbledhjen e 28-të mbajtur me 31.05.2024

Në pikën 2 të kësaj mbledhje: Kryesuesi i Komitetit z. Jeton Rrahmani sa i përket Raportit të punës së ZKKK-së për periudhën Janar-Mars 2024 fjalën për ta sqaruar ia kaloi znj. Snezhana Nestorovica cila në pika të shkurta e arsyetoi Raportin e punës së ZKK-së për periudhën Janar-Mars 2024. Anëtarët e Komiteti për Komunitete unanimisht e miratuan Raporti i punës së ZKKK-së për periudhën Janar-Mars 2024. Në pikën 3 Kryesuesi i Komitetit z. Jeton Rrahmani sa i përket Deponive ilegale të mbeturinave në lagjen "Adem Voca", jemi të informuar nga qytetarët por edhe nga vizitat që i kemi bë në si komitet e kemi pa se ka mjaft probleme në atë lagje por më shqetësuese është mos marrja e mbeturinave në lagjen Adem Voca, pra ne nuk e dimë arsyen se pse nuk pastrohet ajo pjesë a është arsyeja pagesa apo çka, andaj ne si Komitet u dakorduam që ta ftojme në mbledhjen e radhës në takim me Drejtorin e ambientit z. Egzon Sadiku dhe drejtorin e KRM "Uniteti" (me fokus vazhdimi i pastrimit dhe mbledhja ne mënyrë te rregullt dhe periodike ne lagjen Adem Voca). Ndërsa në pikën 4: Kryesuesi i Komitetit z. Jeton Rrahmani lidhur me Diskutimin për hapësirat e Qendrës Mësimore RADC ne si Komitet bashkërisht u dakorduam që ti drejtohem Kryetarit të Komunës me një Rekomandim. Kryesuesi i Komitetit z. Jeton Rrahmani atëherë hedh në votim Rekomandimin: Komiteti për Komunitete i Rekomandon Kryetarit të Komunës që të bëj rishqyrtimin e marrëveshjes për shfrytëzimin të objekteve nga OJQ-të në qendrën mësimore RADC, për shkak se organizatave të cilat operojnë në atë objekt iu ka skaduar kontrata. Komiteti për Komunitete miratoj unanimisht Rekomandimin e propozuar.

Në mbledhjen e 29-të mbajtur me 28.06.2024:

Në këtë mbledhje në rend të ditës Komiteti për Komunitete kishte: Informatë nga drejtori i Drejtorisë së DMMP-së rreth pastrimit të ambientit të rregullt dhe periodik të ambientit në lagjen Adem Voca. Kryesuesi i Komitetit z. Jeton Rrahmani: në mbledhjen e kaluar jemi dakorduar që të ftojme drejtorin e ambientit z. Egzon Sadiku që të diskutojmë rreth Deponive ilegale të mbeturinave në lagjen "Adem Voca", që të dimë se arsyeja pse nuk merren mbeturinat në lagjen Adem Voca, pra ne nuk e dimë arsyeja pse nuk pastrohet ajo pjesë, a është arsyeja pagesa apo çka, pra drejtor fjalën po ua kaloj që të na jepni informatë rreth pastrimit të ambientit të rregullt dhe periodik të ambientit në lagjen Adem Voca. Egzon Sadiku: Përshëndetje për të gjithë, pastrimi sikurse në gjithë qytetin bëhet edhe në lagjen Adem Voca pra ato pastrohen si deponi ilegale edhe pse me rregull janë pika të rregullta të grumbullimit, por arsyeja se ata inkasimin e kanë në gjendje të rëndë, pra inkasimi është rreth 2 %, atëherë ne jemi të obliguar që të bëjmë pastrimin përmes kontratës së deponive ilegale. Banorët e asaj lagje dalin në qytet mbledhin mbeturina shkojnë i selektojnë, pra pjesa që ju duhet e marrin dhe e shesin ndërsa pjesën tjetër e gjuajnë për rreth kontejnerëve mandej po ju mundësohet edhe të tjerëve sikurse qytetarëve dhe kompanive që të hedhin mbeturina në atë pjesë e kështu që pastaj aty po krijohet deponi ilegale. Kryesuesi i Komitetit z. Jeton Rrahmani: E faleminderoi drejtorin z. Egzon Sadiku për informatat e dhëna.

Në mbledhjen e 30-të mbajtur me 10.07.2024:

Në këtë mbledhje u diskutua, qasja në arsim për fëmijët e komunitetit që e kanë ndërprerë shkollimin. Kryesuesi i Komitetit z. Jeton Rrahmani: Ndërprerja e shkollimit nga fëmijët e komunitetit jo shumicë është evidente e sidomos te komuniteti ashkali dhe egjiptian. Ne si Komitet për Komunitete do të avokojmë te organet kompetente që asnjë fëmijë të mos mbetet pa shkollim. Do të kërkojmë nga DKA numrin e saktë të fëmijëve që kanë braktisur shkollimin dhe pastaj do të bisedojmë se cilat politika do t'i përdorim që këta fëmijë t'i kthehen shkollimit, njëherë të dihet numri, shkaqet e pastaj të dalim me një rekomandim për DKA-në. Pas diskutimeve nga anëtarët e Komitetit për Komunitete unanimisht u pajtuan që pas statistikave të marra nga DKA për numrin e fëmijëve nga komuniteti jo shumicë kanë ndërprerë shkollimin dhe pas informatave nga përfaqësuesit e komuniteteve se sa fëmijë nga ky komunitet vijojnë mësimet në veri dhe sa nuk kanë shkollim fare, në një prej mbledhjeve të ardhshme do të dalim me një rekomandim për DKA-në se si të ndërpritet kjo dukuri.

Në mbledhjen e 31-të mbajtur me datë.02.08.2024:

Në këtë mbledhje u shqyrtua Raporti i ZKKK-së për periudhën Janar-Qershor 2024. Zv. Kryesuesja e Komitetit znj. Elidiana Budini Haziri për ta arsyetuar Raportin e ZKKK-së për periudhën Janar-Qershor 2024 fjalën ia kaloi Përfaqësuesit të ZKKK-së Enes Kacapor. Pas arsyetimit të Raportit të ZKKK-së për periudhën Janar-Qershor 2024 nga Përfaqësuesi i ZKKK-së Enes Kacapor, u hap diskutimi. Elidiana Budini Haziri: U tha që 95% e komunitetit jo shumicë marrin ndihma nga zyra juaj, ata të cilën nuk mund të ndihmohen a i drejtoni në drejtorinë komunale dhe organizata të ndryshme dhe sa ka bashkëpunim. Enes Kacapor: Po ne i drejtojmë nëpër drejtorin, por prapë të njëjtit kthehen te na, nuk ka bashkëpunim. Pas nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim Zv. Kryesuesja e Komitetit znj. Elidiana Budini Haziri mbylli mbledhjen.

Në mbledhjen e 32-të mbajtur me datë 30.09.2024:

Raport mbi nevojat e organizatave lokale me bazë në komunitet për shfrytëzimin e objekteve publike, z. Edin Lahu, pas prezantimit të raportit të punës 5 vjeçare të Qendrës së Bashku dhe Strategjisë për 5 vitet e ardhshme, në pika të shkurta foli për aktivitet të cilat i kanë dhe për vijueshmërinë e tyre, po ashtu kërkoi që të na mundësohet vazhdimi i kontratës për shfrytëzimin e objektit të cilin e kanë në shfrytëzim. Esat Krasniqi: Dua ta ndaj me ju dhe të ju tregoj që kam marr pjesë disa herë në aktivitete të cilat i ka pasur OJQ Së Bashku me të vërtet ka qenë të rëndësishme dhe ju kisha propozuar që të merrni pjesë edhe ju. Komiteti për Komunitete u zotuan një zëri se do mundohen ta gjejnë një zgjidhje që ti dalin në ndihmë organizatës OJQ-së “Së Bashku” si dhe organizatës tjetër të cilat e shfrytëzojnë këtë objekt.

Në mbledhjen e 33-të mbajtur me datë 30.10.2024:

Kryesuesi i Komitetit propozoi që pika 2 “Raporti i ZKKK-së për periudhën korrik-shtator 2024 “ të shtyhet për mbledhjen e radhës ndërsa sot drejtori i DSH-së do të na informoj lidhur me aktivitet në kuadër të fushatës “ Tetori muaji i ndërgjegjësimit kundër kancerit të gjirit. Fahri Shabani: Në pika të shkurta foli për aktivitet të cilat i kanë organizuar drejtorja e shëndetësisë dhe në kuadër të fushatës Tetori muaji i ndërgjegjësimit kundër kancerit të gjirit. Elidiana Budini Haziri: A janë të interesuar vajza të reja për ta marr vaksinën që i mbron nga kanceri i qafës të mitrës. Fahri Shabani : Janë organizuar fushata vetëdisuese për këtë qëllim por fatkeqësisht shumica e prindërve po hezitojnë të i sjellin vajzat e tyre për ta marr këtë vaksinën, sapo vajza ime te arrin moshën për ta marr vaksinën unë do ta dërgoj ta merr dhe këtë do ta bëj publike që ta dinë të tjerët që nuk paraqet rrezik. Kryesuesi i komitetit e falënderon drejtorinë për informatën e dhënë.

3. BASHKËPUNIMET ME AKTERË VENDOR DHE NDËRKOMBËTAR

Si Komitet për Komunitete kemi arrit që të krijojmë bashkëpunim të mirëfilltë me akterët vendor dhe ndërkombëtarë për realizimin dhe zbatimin edhe të aktiviteteve sipas planit të punës mirpo edhe për të përmirësuar kapacitete tona si komitet.

Ndër to do ti veçoja:

- Misioninin e OSBE-së në Kosovë
- Misionin UNMIK në Kosovë
- Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim
- Zyrën e Kryesuesës së Asamblesë Komunale znj. Vesa Broja
- Drejtoritë e Drejtorive

4. TË ARRITURAT DHE SFIDAT

4.1 Të arriturat:

- Bashkëpunimi me perfaqesues te lagjeve
- Bashkëpunimi me ZKKK
- Hartimi i Planit të punës për vitin 2024
- Rekomandime të derguara tek Drejtorit dhe Kryetari

4. 2 Sfidat:

- Rrezikimi nga vershimet e lumit Sitnica ,tash qe kemi hyre ne kohe me mot te lige
- Ndriqimi publik ne disa rruge te lagjes 2 Korriku
- Perfaqesimi lokal (ceshtja e nenkryetarit per komunitete)

- Punesimi i nje zyrtari / zyrtareje ne ZKKK nga rradhet e komuniteteve Rom,Ashkali dhe Egjiptian
- Ndhurma institucionale per Qendren e Komuniteteve (mbrapa restaurant Va Piano)
- Te ndryshme

5 KONKLuzionET DHE REKOMANDIMET

5.1 Konkluzionet:

5.2 Rekomandimet:

- Komiteti për Komunitete i Rekomandon Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Infrastrukturës që të rregullohet ndriçimi publik në lagjen “Adem Voca” dhe në lagjen “2 Korriku
- Komiteti për Komunitete i Rekomandon Kryetarit të Komunës që të bëjë rishqyrtimin e marrëveshjes për shfrytëzimin të objekteve nga OJQ-të në qendrën mësimore RADC, për shkak se organizatave të cilat operojnë në atë objekt iu ka skaduar kontrat

Kryesuesi i Komitetit për Komunitete



Jeton RRAHMANI

Dhjetor 2024